



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Kompleksi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën “5 Dëshmorët”, Suk 1”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punë ndërtimore- 45; Punime në natyrë për terren sportiv ose zona rekreative- 45112720-8; Punime ndërtimi për parqe lojrash-45212130-6; Punime ndërtimi për facilitete sportive -45212200-8;**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 41 539 346.30 (dyzetë e një milion e pesëqindë e tridhjetë e nëntë mijë e treqindë e dyzetë e gjashtë pik tridhjetë) lekë pa tvsh,**

**Argumentimi i fondit limit:** Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit ka marr në dorëzim project-preventivin dhe dokumentacionin teknik përkatës të hartuar nga Shoqëria “A.SH.Engineering” shpk i cili rezulton sei është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Shoqëria “A.SH.Engineering” shpk për llogaritjen e cmime është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631, datë 26.10.2018 ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit : “E hapur” është sepse fondi limit është mbi kufirin e ulët monetar, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenin 42 dhe 52”, i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenin 11, pika 1, gërma b) dhe neni 47,74,77 .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik";", Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik", Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

*c. Formulari i Ofertës sipas Shtojcës 1*

*d. Lista e çmimeve të artikujve sipas zërave të preventivi sipas shtojcës 2;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma "ç" (sipas Shtojcës 1 dhe 2 te DST).

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## **2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik";nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

**Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.**

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet e përkatësisht: 41 500 000 lekë pa tvsh.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

---

*Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2021, 2022 dhe 2023, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009

*“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2023** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore .

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme :

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllorarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës e përkatësisht: 20 000 000 lekë pa tvsh.

**Ose**

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet e përkatësisht: 83 000 000 lekë pa tvsh.

*\*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që

prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

***Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava (pika a(1,2,3,4,) dhe b(1,2,3,4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

- **N.P-1 A** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P-2 A** Ndërtime civile dhe industrial;
- **N.P-7 A** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje;

**Për punimet speciale të ndërtimit:**

- **N.S-2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- **N.S-14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

*Kategorite dhe nivelet e licencave te kerkuara jane bazuar ne Lidhjen 2,3 dhe 4 te VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

<b>KATEGORIA</b>	<b>Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorie respektive</b>
N.P. 1-A Punime gërmimi në tokë	Konsiderohen gërmimet, sistemi met dhe ndryshi met në vullmetë tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e	Germim dheu me krah e transport me k dore10m,kategorialll. Germim dheu per drenazhet dhe per fushen Transport dheu auto deri 3 km Mbushje ngjeshje dheu Germim dheu me krah Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h-1.5m Mbushje e ngjeshje dheu me krah Mbushje blindash me zhavor Germim dheu me krah	Niveli A





strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësimi dhe pajisje.	Beto c=16/20 per bordure 15/50 per rrethimin e fushes		
	FV porta futbollit te kompletuara me rrjet		
	F.V katror/tubo hekuri d= 10 cm		
	Rrethim fushe me tel gabion		
	Porte metalike rreshkitese		
	Kollona b/a per fiksimin e portes		
	Hekur per kollonat		
	mbjellje bari natyral		
	Boje e bardhe bikarbonate per vijezime		
	Beton c=16/20 per shkallaret e stadiumit		
	Beton c=16/20 per murin mbajtes		
	Hekur per betonin		
	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri		
	Shtrese betoni betoni C 16/20		
	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm		
	Rrethim fushe me tel gabion		
	Konstruksione metalik te zinguar per rrethimin		
	F.V. Ndricues fluoreshent 3x40w.IP65		
	Shtrese bari artificial 5cm		
	F.V Tel I veshur me plastik		
	F.V porta futbollit te kompletuara me rrjet		
	Mbushje blindash me zhavor		
	Shtres betoni C12/15		
	Trare arkitrare b/a C20/25 h deri 4m		
	Trare themeli b/a C 20/25 monolit		
	Soleta te plota b/a C 20/25 t = 17 cm, h ~ 4m		
	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri		
	Shtrese betoni betoni C 16/20 per fund bordurat		
	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm		
	Rrethim fushe me tel gabion		
Konstruksione metalik te zinguar per rrethimin			
F.V. Ndricues fluoreshent 3x40w.IP65			
F.V Tel I veshur me plastik			
F.V porta futbollit te kompletuara me rrjet			
Trotuar me 6cm beton me pllaka			
FV bordura betoni 15x30cm			

- N. P-7 A Uj esj ell esa , ga zsj ell esa , vaj sje lle sa, ve pra kul lim i dh e va ditj e;	Konsid erohen ndërti me, mirëm bajtje ose ristrukt urime me ndërhy rje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbi mit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdori mit të gazrave dhe veprave lidhëse , plotësu	Puseta betoni 40x40x100 me kapak gize Puseta betoni 150x150x200 F.V. tub I brinjezuar sn8 d=600mm F.V. tub I brinjezuar sn8 d=315mm F.V. tub gress d=200mm, per drenazhimin e fushes Mbushje drenazhi me zall lumi Mbushje blindash me zhavor Shtres betoni C12/15 Trare arkitrare b/a C20/25 h deri 4m Trare themeli b/a C 20/25 monolit Soleta te plota b/a C 20/25 t = 17 cm, h ~ 4m	Niveli A

	<p>ese ose ndihmë se edhe në pika të veçant a si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal .</p>		
- N. S-2 A Im	Konsiderohet, montimi,	<p>F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=25mm, PN 16</p> <p>F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=32mm, PN 16</p> <p>F.V Pilete grumbulluese shume dalje</p> <p>Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm</p>	<p>Niveli</p> <p>A</p>

pia nte hid ros ani tar e, ku zhi na, lav ant eri, mi rë mb ajtj a e tyr e;	mirëm	Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm		
	bajtje	F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm		
	ose	F.V WC allafrenga importi		
	ristrukt urimi	F.V lavaman porcelani importi me mishelator		
impian teve hidrosa nitare të kuzhin ës, lavante risë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësi së së veprav e, e komple tuar me punime t e muratu rës plotësu ese ose ndihmë se, që janë realizu ar ose janë duke u realizu ar në punime t e përgjit				

	hshme.		
- N. S-4 A Puni me rifiniture të murat urës dhe lidhur a me to, rifiniturë me matriale duri, plaste, me talle dhe xhami dh	Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi i murat urës dhe mureve ndarëse të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punimet ngjashme me ato. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punime	<p>Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva.</p> <hr/> <p>Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25</p> <hr/> <p>Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah</p> <hr/> <p>Shtresë me pllaka gres importi 40cmx40cm</p> <hr/> <p>Plintuse pllake grez</p> <hr/> <p>Veshje me pllake majolike</p> <hr/> <p>Dritare d/alumini dyfish xham.</p> <hr/> <p>Dyer te blinduara importi.</p> <hr/> <p>F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re.</p> <hr/> <p>Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25</p> <hr/> <p>Suva jashta mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 26</p> <hr/> <p>Brez betoni me tulla</p> <hr/> <p>Mur tulle te plotu bulme 12cm, h=3m, llaç I perzier M15</p> <hr/> <p>Mur tulle te lehtesuara deri 3m, llaç perzier M-15</p> <hr/> <p>Lyerje me boj hidroplastike brenda ambienteve te nderrimit</p> <hr/> <p>Lyerje me boj tavani dhomat e zhveshjes</p>	Niveli A

<p>e rifi nit urë të nat yrë s tek nik e nd ërt ues e;</p>	<p>ve prej druri, të dyerve dhe dritare ve të brends hme dhe të jashtm e, të veshje ve të brends hme dhe të jashtm e të dyshe meve të tipeve të ndrysh me dhe me materia le të ndrysh me dhe të punime ve të realizu ara me dorë, me metal, dru, materia l plastik dhe materia l xhami</p>		
--	--	--	--

	ose të ngjashëm.		
- N. S-14 A Im pia nte të bre nd sh me ele ktr ike , tel efo nik e, rad iot ele fon i TV ;	Konsid erohet monti mi, mirëm bajtja dhe ristrukt urimi I linjave elektri ke, telefon ike, radiote lefoni e TV, si edhe të linjave të transm etimit të ngjash me me to, të komple tuar me çdo punim të lidhur me muratu rën, plotësu ese ose ndihmë se, për t'u realizu	F.V Kasete plastike KE me 8 modular (vende)	Niveli
		F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A	A
		F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	
		Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40 led 60x60 4vW	
		F.V percjelles Ø 1.5mm	
		F.V percjelles Ø 2.5mm	
		Elektroda tokezimi profil zingato e bakerizuar l=1.5m	
		F.V priza shuko universal	
		F.V priza shuko universal ETHERNET	
		F.V Kutiderivacioni plastike	
		Percjelles togezimi bakrri Cu 30*3mm	
		F.V tub plastmasi Ø 22 ~ 26 mm	
		F.V. Kasete plastike KE 36 modular(vende)	
		F.V priza shuko	
		F.V Celesa e priza 10A	
		F.V Percjelles PV-500 Ø 6mm2	
		F.V Percjelles PV-500.1x2,5mm2	
		F.V Percjelles PV-500.1x4mm2	
		F.V. Tubo P.V.C.fleksibel Ø63	
		F.V. Tubo P.V.C.fleksibel Ø25	
		F.V. Tubo P.V.C.fleksibel Ø20	
		F.V Kuti derivacioni plastike	
		F.V Automat termo/el.manj.diferencial 2P 22V, 32A dl=0.03A	
		F.V Automat termo/el.manj.diferencial 2P 22V, 16A	
		Ndricues fluoreshent 4x18wxIP40 led 60x60 40W	
		F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	
		Llamba sinjali	
		F.V. Siguresa 25A	
		F V shtylla metalike per ndricim H-7m, d-160mm	
		F V shtylla metalike per ndricim H-7m, d-160mm	
F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm			
F.V Automat Magneto termik 220V, 10 A, 2P			
Furnizim vendosje tuba plastmasi Ø 80			
FV krah dy degesh per shtylla metalike			
FV krah per shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10			

ar, të ndara nga zbatimi I sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.	FV kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement
	Percjelles togezimi bakrri Cu 30*3mm
	F.V percjelles Ø2.5mm
	Elektroda tokezimi profil zingato e bakerizuar l=1.5m

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme (sipas Lidhjes 3)

- Kategoria NP-1 A (Punime gjermimi në tokë)

Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë gjermimet për themelet e godines së re, gjermim për kanalizimet KUZ të shkollës, gjermime dhe sisteme të ndryshme të shesheve për ndërtimin e terreneve sportive, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NP-2 A (Ndërtime civile dhe Industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë ndërtimin nga e para të strukturës së re dhe shkallareve të fushës, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NP-7: A (Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje)



Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Referuar zerave të preventivit, janë parashikuar drenazhimi i ujërave në sipërfaqjen e fushes, lidhja me rrjetet kryesore të ujësjellësit dhe kanalizimeve të zonës dhe riparimi i prishjeve të mundshme të rrjeteve. Duke marrë në konsideratë proceset e mesiperme të punës operatorit ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë.

- Kategoria NS-2 A (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundërzjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë punimet për njëjtë sanitare, furnizimin me ujë të pajisjeve hidrosanitare, impiantet e mbrojtjes ndaj zjarrit, dhe sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë të gjithë zerrat e përmendur më sipër, operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

- Kategoria NS-14 A (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv etj)

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur

me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi I sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve, ku përfshihen punimet e pajisjet elektrike, si implementimi i kuadrove elektrik me aksesoret perkates, ndricimi i jashtem i fushes me prozhektoret sipas preventivit, instalimet e brendshme të fuqise dhe ndricimit, si dhe sistemi kompjuterik, sistemit të alarmit inteligjent, i telekomunikacionit të bashku me linjat e internetit dhe sistemin e kamerave, operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

**2.3.3. a.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, jo më pak, si më poshtë:

- |  |         |
|--|---------|
| - Inxhinier Ndertimi Profili Konstruktor/Strukturist | 1 (një) |
| - Inxhinier Ndertimi Profili Gjeoteknik              | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektrik                                 | 1 (një) |

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV
- Licence

Secili prej drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **për muajin e fundit.**

*\* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të

legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafii i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

### **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Konstruktor/ Strukturist** kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndertohet sipas parashikimeve në projektin.
- **Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Gjeoteknik** ka rëndësi të vecantë sidomos në rastin konkret me fushën e përcaktimit të karierave të materialeve që do të përdoren për nenshtrese zhavori, për shtresë stabilizuese si dhe për materialet që do të përdoren për pllaken e themelit dhe për materialet e betoneve te tjera.
- 1 (një)**Inxhinier Elektrik** jane te nevojshem, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, punimet elektrike do te ndahen ne disa fronte te rendesishme njekohesisht, si instalimi i kuadrove elektrike bashke me aksesoret perkates, impianti i instalimeve te fuqise dhe ndricimit (i brendshem), sistemi i furnizimit te rezervuar me energji elektrike, dhe ndricimi i jashtem i fushes.

**b b.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) “Auditues Energjitik në Ndërtesa dhe Instalime Industriale”,
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

### **Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV

Secili prej inxhinierëve të mesipërm të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" I ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- **“Auditues Energjistik në Ndërtesa dhe Instalime Industriale”,** Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për eficientësin e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen “çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo **i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm**”, si dhe bazuar në VKM nr. 407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet Certifikata e Audituesit Energjistik”, ku parashikohet se: a) “Certifikatë e audituesit energjetik”, certifikata e lëshuar nga Agjencia për Eficientësin e Energjisë (AEE), që vërteton kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri.

Referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime, të cilat lidhen me eficientësin e energjisë si sistemi i ndricimit të komplekseve sportive, izolimi akustik, hidrik dhe termik, pra jemi në kushtet që duhet një Auditues Energjistik në bazë të VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.

c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

<b>EMERTIMI</b>	
Teknik të mesëm ndërtimi	(1 person)
Teknik të mesëm elektrik / elektroteknik	(1 person)
Teknik të mesëm topograf / gjeodet / gjeometer	(1 person)
Karpiertier	(1 person)
